

**PERMBLEDHJE JO TEKNIKE E  
VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS  
PER AKTIVITETIN:  
"Shfrytëzimi i Mineralit Hekur-Nikel"**

Vendodhja : Fshati Domaj, Njesia  
Administrative Gjinaj, Bashkia Has, Qarku  
Kukes

Kërkues: Subjekti: "KASTRIOTI MINERAL"  
Sh.p.k

Referuar shtojces: (sipas ligjit 10440 shtojca  
I pika 19)

Hartoi raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:

"ENVIRONMENTAL MANAGEMENTS CONSULTANTS" Sh.p.k

Administrator

Elidiana Shehu



Altin Ahmeti

(Çert. 261, Nr. 11657 Prot, dt. 10.12.2014 )

Ing. Elidiana Shehu

(Lic. 146, Nr. 5113 Prot, date 28.07.2013)

Tetor, 2015

**PASQYRA E LENDES**

1.	TE PERGJITHSHME, PERSHKRIM I SHKURTER I PROJEKTIT TE PROPOZUAR .....	2
1.1.	Hyrje.....	2
1.2.	Projekti i Propozuar.....	3
	Objekti i projektit të propozuar.....	3
2.	MBI LEGJISLACIONIN MJEDISOR DHE PERPTHJET E TIJ ME ATE NDERKOMBETAR .....	6
2.1.	Qellimi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis.....	6
2.2.	Kuadri ligjor kombetar .....	7
2.3.	Permbledhje e kuadrit ligjor.....	8
2.4.	Metodologjia e Vleresimit .....	9
3.	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË SHFRYTËZIMIT TË MINERALIT TË HEKUR-NIKELIT. 10	
3.1.	Te pergjithshme .....	10
3.2.	Vendndodhja e projektit. ....	11
3.3.	Pershkrimi i projektit.....	12
3.4.	Mbetjet e ngurta (Sterilet).....	15
4.	VESHTRIM MBI MJEDISIN E RAJONIT TE IMPLEMENTIMIT TE PROJEKTIT .....	16
4.1.	Te pergjithshme per Bashkin Has .....	16
4.2.	Klima. ....	19
4.3.	Ekosistemet, flora, fauna.....	20
4.4.	Kushtet klimatike .....	20
4.5.	Sizmiciteti ne rajon .....	20
4.6.	Cilësia e ajrit.....	21
4.7.	Mjedisi biologjik i rajonit .....	22
5.	VLERESIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS DHE MASAT PARANDALUESE GJATE SHFRYTEZIMIT TE OBJEKTIT MINERAR DHE PAS MBYLLJES SE AKTIVITETIT.....	23
5.1.	Te pergjithshme .....	23
5.2.	Vleresim i impakteve kryesore ne mjedis .....	23
5.3.	Ndikimet nderkufitare .....	28
5.4.	Menaxhimi i mbetjeve te ngurta .....	28

# **1. TE PERGJITHSHME, PERSHKRIM I SHKURTER I PROJEKTIT TE PROPOZUAR**

## **1.1. Hyrje**

Ekonomia shqiptare është duke u zhvilluar me ritme të shpejta në drejtim të integritit të saj rajonal, Evropian dhe botëror. Vendi ynë aktualisht është duke u përballur me sfidat e integritit në Bashkimin Evropian, gjë e cila përfshin angazhimin për ndërtimin e kapaciteteve të reja ekonomike, përshtatjen e teknologjive, si dhe integrimin e ekonomisë shqiptare në hartën e tregjeve rajonale dhe ndërkombëtare. Ky përbën një proces kryesor për të garantuar koherencën dhe vazhdimësinë e strategjive, të reformave, si dhe të prioritetëve të ekonomisë shqiptare, të cilat janë të nevojshme në kushtet e një ekonomie të tregut të lire. Arritja e këtyre objektivave parësore do të bëhet e mundur nëpërmjet politikave efektive, konsolidimit dhe zhvillimit të sektorëve kryesorë të ekonomisë kombëtare, konsolidimit të institucioneve dhe hartimit e implementimit të projekteve, të cilët realisht do ta integrojnë ekonominë Shqiptare, duke u bazuar në drejtimet kryesore të “Strategjisë Kombëtare për Zhvillimit dhe Integritit”, si dhe në strategjitë sektoriale dhe rajonale. Përpjekjet konstante për harmonizimin e politikave të rritjes ekonomike me kërkesat e standardeve mjedisore, përbejnë gjithashtu një drejtim tjetër themelor të programeve të Qeverisë për një zhvillim të qëndrueshëm të vendit.

Eksperienca e vendeve të zhvilluara ka treguar se, për të pasur një zhvillim normal të sektorit industrial duhet të vendoset një balancë e drejtë ndërmjet politikave qeverisëse dhe mekanizmave të tregut, si dhe menaxhimit të energjisë.

Ky aktivitet ka si synim shfrytëzimin e mineralit të Hekur-Nikelit në vendburimin Domaj, Njesia Administrative Gjinaj, Bashkia Has, Qarku Kukës Kompania ka të qarte rrugën dhe hapat për ta realizuar këtë projekt në variantin e tij më optimal.

Nëpërmjet këtij raporti të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis do të jepet një informacion i detajuar i projektit të shfrytëzimit, informacion mbi zonën dhe popullsinë e saj, punimet që do të kryhen, ndikimet në mjedis nga zbatimi i projektit, masat që duhet të merren për minimizimin e këtyre ndikimeve, si dhe impaktin ekonomik-social.

## 1.2. Projekti i Propozuar

### Objekti i projektit të propozuar.

Objekti i projektit të propozuar është shfrytëzimi i mineralit Hekur-Nikel në objektin e Hekur-Nikelit “Domaj”, fshati Domaj, Njesia Administrative Gjinaj, Bashkia Has, Qarku Kukës.

Ky projekt në teresi rezervon një sipërfaqe prej 0.647Km<sup>2</sup>, ose 64.7 Ha.

Te dhënat teknike të projektit janë si më poshtë:

**Nga studimet gjeologjike të kryera rezultoi që në këto zone të këtyre një sasi rezervash prej rreth 700 000 tone me përmbajtje Ni-0.9% dhe Fe-30%.**

Në tabelën e mëposhtme paraqiten koordinatat e vendodhjes së zonës minerare.

Pika	Koordinatat	
	Y	X
1	44 54 217	46 65 144
2	44 54 298	46 65 490
3	44 54 705	46 65 706
4	44 55 003	46 65 443
5	44 55 120	46 65 542
6	44 55 587	46 65 463
7	44 55 733	46 65 258
8	44 56 495	46 66 331
9	44 56 946	46 66 292
10	44 57 206	46 66 427
11	44 57 256	46 66 274
12	44 56 929	46 66 050
13	44 56 364	46 66 130
14	44 55 735	46 65 244
15	44 55 236	46 64 988
16	44 54 653	46 65 476
17	44 54 569	46 65 463
18	44 54 262	46 65 128
<b>S<sub>K</sub> = 0.647 Km<sup>2</sup></b>		

### Harta e zones ne vleresim



#### Procesi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Studimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) siguron një përmbledhje të të dhënave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e mjedisit ku do të shfrytëzohet për germimin dhe nxjerrjen e mineralit, përfshirë kushtet fizike, të burimeve ujore, biologjike, atmosferike, burimet kulturore dhe gjendjen social-ekonomike. Në procesin studimor të VNM përdoren informacioni dhe të dhënat ekzistuese të përfituara rishtas mbi kushtet e mjedisit të sheshit që do të shfrytëzohet, së bashku me standardet dhe normat e zbatueshme për të vlerësuar impaktet potenciale mjedisore dhe sociale të fasiliteve të propozuara.

#### Kërkesat e studimit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Impaktet potenciale mjedisore të shqyrtuara dhe të analizuar në procesin e VNM përfshijnë impaktet ndaj cilësisë së ujit, burimet tokësore dhe ujore, cilesine e ajrit, tokes, mjedisit biologjik dhe situatën social-ekonomike dhe kulturore. Burimet e vlerësuara social-kulturore përfshijnë punësimin, përdorimin e tokës, peshkimin, lundrimin lokal, transportin rrugor dhe hekurudhor dhe shërbimet e komunitetit vendas.

VNM përvijon gjithashtu edhe masat zbutëse për t’u zbatuar për të ndihmuar parandalimin ose minimizimin e ndikimeve negative, siç mund të jetë e praktikueshme, të impakteve mjedisore dhe sociale të projektit të propozuar. Këto raportohen në detaje në planin e menaxhimit të mjedisit (PMM), i cili është pjesë e raportit. VNM-ja përbëhet nga tërësia e procedurave të shfrytëzimit të burimit, rehabilitimit dhe monitorimit.

Plani raporton edhe veprimet që nevojiten për t’i zbatuar këto masa. Për më tepër, VNM-ja trajton menaxhimin specifik të mjedisit dhe planet e strategjitë monitoruese dhe identifikon çdo kërkesë dhe afat të domosdoshëm të kërkuar.

**Korniza kryesore e kuadrit ligjor për përgatitjen e këtij Raporti të thelluar të VNM:**

- **Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit”**
- **Ligji Nr.10 440, datë 7.7. 2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.**

Metodologjia e hartimit të këtij raporti të VNM është hartuar në përputhje me kërkesat dhe percaktimet e Vendimit të KM Nr. 13, datë 04.01.2013 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”

Metoda e përgatitjes së VNM

Metodologjia e përdorur për përgatitjen e raportit të VNM-së u bazua në:

- Rishqyrtimin e politikave, rregullave, udhëzimeve operacionale dhe masave organizative institucionale ekzistuese në Shqipëri për të zgjidhur dhe lehtësuar impaktet shoqërore dhe mjedisore të studimit;
- Vlerësimin e përputhshmerisë së parimeve baze të rregullave shqiptare duke identifikuar boshllëqet dhe duke paraqitur rekomandime për t’i zgjidhur ato;
- Përgatitjen e udhëzimeve për identifikimin dhe vlerësimin e natyrës dhe magnitudës së impakteve mjedisore dhe sociale, duke përfshirë përgatitjen e kriterëve seleksionues socialë dhe mjedisore për të përzgjedhur projektet për implementimin dhe për të përcaktuar nivelin e studimeve/vlerësimeve sociale dhe mjedisore që kërkohen;
- Sugjerimet mbi modalitetet për përgatitjen e masave lehtësuese të nenprojektit në lidhje me zonën ku po ekzekutohet ky i fundit.

Institucionet përgjegjëse kanë në organiken e tyre një sërë inspektorësh dhe teknike si në nivelin qendror ashtu dhe në atë rajonal, si dhe një specialist të mjedisit, që do të jetë përgjegjës për monitorimin e këtij studimi dhe të vlerësimeve të tjera mjedisore specifike si dhe do të trajtojë njesitë e qeverisjes vendore për t’iu përmbajtur kërkesave të parashtruara në Leje Mjedisore.

Për hartimin e raportit të VNM, porositeshi vuri në dispozicion të hartuesve të raportit materialin teknik të disponueshëm, juridik e projekt-shfrytëzimin.

## **2. MBI LEGJISLACIONIN MJEDISOR DHE PERPTHJET E TIJ ME ATE NDERKOMBETAR**

### **2.1. Qellimi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis**

VNM eshte nje proces sistematik per te percaktuar dhe vleresuar efektet apo ndikimet ne mjedis te nje veprimi apo projekti te caktuar. Ne nje situatë normale, ky proces aplikohet perpara se te merret vendimi dhe te fillojne angazhimet per realizimin e projektit. Po sidoqofte, dhe ne çdo kohe, efektet sociale, kulturore dhe shendetesore jane konsideruar si pjese integrale e VNM. Kujdes i veçante i kushtohet praktikave te VNM per te parandaluar dhe minimizuar efektet e mundshme negative te veprimeve te ndermarra.

Qellimi i VNM eshte te:

- Te jape informacion per vendimmarresit per pasojat mjedisore te studimet e propozuara; dhe
- Te promovojë zhvillimin miqësor dhe te qendrueshem me mjedisin duke identifikuar masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis

Reduktimi i ndikimeve ne mjedis arrihet nese nje zhvillim behet i qendrueshem me mjedisin. Keto ndikime jane mjaft komplekse, me te medha ne shkalle dhe per me teper shtrijne pasojat e tyre me shume se 10 vjet me pare ku u fut koncepti i VNM ne vendin tone. Si rezultat, VNM eshte kthyer ne nje vegël kyç per vendimarrjen per nje zhvillim te propozuar.

Ne aspektin nderkombetar, roli i VNM eshte njohur ne Principin e 17 te Deklarates per mjedisin dhe Zhvillimin.

VNM, si nje instrument kombetar duhet te aplikohet per aktivitetet e propozuara te cilat pritet qe te kene ndikim negativ ne mjedis dhe jane subjekt i nje vendimarrje te nje autoriteti kombetar.

Qellimi dhe objektivat e VNM mund te ndahen ne dy kategori.

Qellimi i pare, drejtperdrejte, eshte te informoje procesin e vendimarrjes duke identifikuar te konsiderueshem potencialet ne mjedis dhe rreziqet e perfitimet e projektit dhe zhvillimit te propozuar.

Qellimi perfundimtar, afatgjate i VNM eshte te promovojë zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe propozimet e projektit nuk minojne burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe te njerezëve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose aktivitet.

Objektivat afatshkurter dhe te drejtperdrejte te VNM:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore i propozimit dhe projektit;
- Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me eficence;
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale te projektit apo propozimit; dhe
- Lehteson informimin e vendimmarresit, duke perfshire vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit apo propozimit.

Objektivat afatgjate te VNM jane:

- Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit;
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, peisazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale te projektit

## 2.2. Kuadri ligjor kombetar

Sa me siper, ky Raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, eshte mbështetur ne legjislacionin mjedisor si me poshte dhe ka per qellim qe te identifikojë, parashikojë dhe parandalojë ndikimin e këtij aktiviteti ne mjedis.

Kuadri ligjor për VNM-ne sigurohet ne menyre te drejtperdrejte nga dy ligje për mjedisin në Shqipëri Ligji Per mbrojtjen e mjedisit dhe Ligji per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis. Keto ligje se fundmi jane perafruar plotesisht me ligjet e Bashkimit European per mbrojtjen e mjedisit dhe Vlersimin e Ndikimit ne Mjedis.

**Bazuar ne Ligjin Nr. 10448, date 14.07.2011 Per lejet e mjedisit, ne Aneksin Nr.1 ,ky projekt klasifikohet ne listen e aktiviteve qe duhet te paisen me leje mjedisore te tipit B per te gjitha instalimet.**

**Sipas Ligjit Nr. 10440, date 07.04.2011 “Per VNM”, shtojca 1 dhe VKM. Nr. 13, datë 4.01.2013 “Për proceduren e VNM-se”, ky projekt duhet ti nenshtrohet procedures se miratimit te VNM se thelluar(Shtojca 1, pika 19 ).**

Ligji mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis (VNM) percakton tipin dhe shkallen e projekteve apo veprimtarive qe kerkojne VNM para implementimit. Kategorite e VNM-ve jane:

VNM paraprake. Ky vlen per projekte qe mund te kene impakte potenciale me te vegjel ne permasa qe serish kerkojne nje vleresim profesional te impakteve te tyre. Keto perfshijne projekte qe jane listuar ne Shojcen 2 te Ligjit per VNM dhe ndryshime apo rehabilitime te projekteve te listuar ne Shtojcen 1 dhe qe nuk klasifikohen ndryshe nga AKM.

VNM i Thelluar. Ky vlen per projekte me impakte potencialisht te konsiderueshme, siç figurojne ne listen e Shojces 1 te Ligjit, ato projekte te listuara ne Shtojcen 2 per te cilet Agjencia Kombetare e Mjedisit mendon se do te kene nje impakt te konsiderueshem mbi mjedisin (bazuar ne informacionin e siguruar nga propozuesi ne kohen e aplikimit) dhe



veprimtarite qe jane per tu implementuar ne zonat e mbrojtura apo zona bregdetare te Republikes se Shqiperise.

### 2.3. Permbledhje e kuadrit ligjor

Nder ligjet e tjera te legjislacionit kombetar ne lidhje me aktivitetin, këtë VNM dhe mjedisin përfshijnë :

- **Ligji Nr 10431 datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”**
- **Ligji Nr 10440 datë 07.07. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit Në Mjedis”**
- **Ligj Nr. 10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”**
- **Ligji Nr. 10463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”**
- **Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”.**
- **Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”**
- **Ligji Nr.10 081, datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.**
- **Ligj Nr.9115, datë 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”**
- **Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”**
- **Ligji Nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura". I ndryshuar me:-Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008**
- **Vendim Nr.1189, Datë 18.11.2009 “Për Rregullat dhe Procedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit”**
- **Vendimi Nr.247, datë 30.04.2014 “Për tërheqjen e mendimit te publikut në vendimmarrje për mjedisin”.**
- **Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 “Per menaxhimin e zhurmave”**
- **Vendim Nr. 313, dt. 09.05.2012 “Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis”**
- **Vendim Nr. 177, datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”**
- **Vendim Nr. 452, datë 11.7.2012 “Për lendfillet e mbetjeve”**
- **Vendim Nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”**
- **Vendim Nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”**
- **Vendim Nr. 538 dt.26.05.2009 “Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregulla te tjera”**
- **Vendim Nr. 13, date 04.01.2013 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”**
- **Vendim i Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL.**
- **Vendim Nr. 676, datë 20.12.2002 “Për shpalljen e zonave te mbrojtura monument natyror”**

- **Vendim Nr 686 date 29.07.2015 “Per miratimin e rregullave te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis dhe procedures se Transferimit te Vendimit e Deklarates Mjedisore”**

Ne parlamentin Shqiptar jane miratuar edhe disa ligje ne kuader te perfshirjes se vendit tone ne Protokolle dhe marreveshje te ndryshme. Nder to permendim:

- **Ligji Nr. 9672 datë 26.10.2000: “Për ratifikimin e konventes se Aarhusit”** Per te drejten e publikut per te pasur informacion dhe perfshirjen ne vendimarrje, si dhe per tju drejtuar gjykates per ceshtjet e mjedisit.
- **Ligji Nr. 9334 datë 16.12.2004: “Për aderimin e Republikes se Shqiperise ne Protokollin e Kiotos” ne konventen per ndryshimet klimatike (UNFCCC).**
- **Ligji Nr. 9424 datë 06.10.2005: “Për ratifikimin e protokollit te vleresimit strategjik mjedisor”.**
- **Ligji Nr. 9486 datë 06.03.2006: “Për aderimin e Republikes se Shqiperise ne Amendamentin e Pekinit per protokollin e Montrealit” Per substancat qe hollojne shtresen e Ozonit.**
- **Ligji Nr. 9548 datë 01.06.2006: “Për aderimin e Republikes se Shqiperise ne protokollin per regjistrat e shkarkimit dhe transferimit te ndotesve”**

#### 2.4. Metodologjia e Vleresimit

Per hartimin e raportit te VNM, porositesi vuri ne dispozicion te hartuesve te raportit materialin teknik, inxhinierik dhe juridik. Ky projekt pergatitet me kerkese te investitorit, subjekti “KASTRIOTI MINERAL” Sh.p.k, si dhe jane kryer inspektime ne terren per identifikimin e elementeve mjedisore dhe te biodiversitetit.

AKM dhe DRM, jane autoriteti kompetent ligjor per te kerkuar, analizuar dhe aprovuar dokumentacionin VNM, ku projekti ne vleresim do ti nenshtrohet procedurave te raportit te thelluar te VNM-se:

Tabela: 1: Kriteret e klasifikimit per procedurat shqiptare te VNM-se

<b>Kategoria sipas Legjislacionit Shqiptar</b>	<b>Procedura qe Duhet Ndjekur (Duke plotesuar Standartet Shqiptare)</b>
Aneksi i Ligjit 10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”	Sipas kerkesave te ligjit Nr 10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”, Shtojca 1 per Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C ky aktivitet klasifikohet per paisje me leje mjedisore te tipit B.
Shtojca 1 dhe 2, Ligji Nr.10440, date 07.07.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pergatitja e procedures se raportit te thelluar te VNM-se, sipas klasifikimit ne shtojcen Nr. 1 pika 19.</li> <li>• Organizimi i konsultimit me publikun, sipas VKM Nr. 13, date 04.01.2013.</li> </ul>

### 3. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË SHFRYTËZIMIT TË MINERALIT TË HEKUR-NIKELIT.


#### 3.1. Te pergjithshme

Objekti i projektit te propozuar eshte shfrytezimi i mineralit Hekur-Nikel ne objektin e Hekur-Nikelit “Domaj” ne fshatit Domaj, Njesia Administrative Gjinaj, Bashkia Has, Qarku Kukës.

Ky projekt ne teresi rezervon nje siperfaqe prej 0.647 Km<sup>2</sup>, ose 64.7 Ha, Te dhenat teknike te projektit jane si me poshte:

**Nga studimet gjeologjike te kryera rezulton qe ne kete zone te kete nje sasi rezervash prej rreth 700 000 tone me permbajtje Ni-0.9% dhe Fe-30%.**

*Foto te zones ne vleresim*



### 3.2. Vendndodhja e projektit.

Projekti ne vleresim per shfrytezimin e mineralit Hekur-Nikel ndodhet ne objektin “Domaj” ne fshatin Domaj,Njesia Administrative , Bashkia Kukes, Qarku Kukes. Vendodhja e objektit minerar pasqyrohet ne harten e meposhteme, e shoqeruar me koordinatat metrike, sipas njoftimit te Ministrise Energjise si autoritet kontraktues.

Ne tabelen e meposhteme paraqiten koordinatat e vendodhjes se zones minerare



Pika	Koordinatat	
	Y	X
1	44 54 217	46 65 144
2	44 54 298	46 65 490
3	44 54 705	46 65 706
4	44 55 003	46 65 443
5	44 55 120	46 65 542
6	44 55 587	46 65 463
7	44 55 733	46 65 258
8	44 56 495	46 66 331



<b>9</b>	<b>44 56 946</b>	<b>46 66 292</b>
<b>10</b>	<b>44 57 206</b>	<b>46 66 427</b>
<b>11</b>	<b>44 57 256</b>	<b>46 66 274</b>
<b>12</b>	<b>44 56 929</b>	<b>46 66 050</b>
<b>13</b>	<b>44 56 364</b>	<b>46 66 130</b>
<b>14</b>	<b>44 55 735</b>	<b>46 65 244</b>
<b>15</b>	<b>44 55 236</b>	<b>46 64 988</b>
<b>16</b>	<b>44 54 653</b>	<b>46 65 476</b>
<b>17</b>	<b>44 54 569</b>	<b>46 65 463</b>
<b>18</b>	<b>44 54 262</b>	<b>46 65 128</b>
<b><math>S_K = 0.647 \text{ Km}^2</math></b>		

### 3.3. Pershkrimi i projektit

#### **Kushtet tekniko minerare te vendburimit**

Si eshte theksuar edhe ne kapitujt e mesiperm ne ndertimin gjeologjik te vendburit, marrin pjese:

- Shkembinjte ultrabazik si poshte shtroje e kores se tjetersuar.
- Korja paresore e tjetersuar.
- Faqja hekurnikelore
- Faqja terrigjene
- Shkembinjte karbonatike (gelqerore) si tavani i kores se tjetersuar.

Shkembinjte ultrabazik si poshte shtroje e kores se tjetersuar jane ne dyshemene e zones minerale perfaqesohen nga shkembinjte, me nje qendrushmeri nen mesatare. Ata sherbejne si ekran per ujrat nentokesore.

Korja paresore e tjetersuar (minerali i hekur-nikelit) takohet me lloje te ndryshme fortesish nga kompakt i forte (nenfaqor paktomorfe e deri ne xeheror te shkrikeruar me qendrushmeri te dobet ( nenfaqja oolito-pizolito-bathore me cemento te kloriteve te hekurit) ku dhe lageshtia shkon deri 11%

Faqja hekurnikelore pergjithesisht eshte e qendrushme, por kur kane lende hekurore, eshte e pranishme ne llojin e kloriteve, atehere qendrushmeria e kesaj lidhjeje ulet dhe shkembimi shpesh paraqitet i shkrikeruar.

Depozitimet terigjene ndodhen ne tavan te trupit (perfaqesohen nga argjila, ranor, shiste mergele etj) jane te bute dhe te pa qendrushem. Siper terigjeneve vendosen gelqeroret e Cr2 me shtresezim te mesem, me fortesi mesatare relativisht te qendrushem.

Meqenese gjate shfrytezimit do te perdoret metoda siperfaqesore e shfrytezimit me karrier e qedrushmerine e tyre ka rendesi per te percaktuar kendin e shuarjes se karrieres duke patur parasysh qe punimet kalojne neper shkembenje e me qendrushmeri te

ndryshme por duhet patur ne konsiderate qe shkembinjte terigjenit te cilet paraqesin edhe probleme me te shumta jane ne tavanin e trupit xeheror. Renia e bute e trupit mineral u jep perparesi ne fazen e dyte sistemit te shfrytezimit me dhuma dhe koolonaapo sisytemit llave. Edhe relievi favorizon kete sistem shfrytezimi.

Gjate shfrytezimit te vendburimit paraqet veshtiresi ndarja e nikel- silikatit sipas klasave. Ne pergjithesi kushtet tekniko-minerare ne kete vendburim jane te mira.

### **Zgjedhja e menyres se shfrytezimit**

Per hartimin e ketij projekti jane bere sakesimet e nevojeshme topogjeodezike, jane marre dhe analizuar mostra, si dhe jane vleresuar shkembinjte anesore. Pajisja me leje shfrytezimi e Subjektit “KASTRIOTI MINERAL” sh.p.k. dhe venia ne zbatim e ketij projekti do te vertetoje vazhdimesine e mineralizimit te Hekur-Nikelit, si dhe do te jete nje premise e mire per te kerkuar me ne renie e shtrirje.

Ne hartimin e projektit te shfrytezimit te ketij objekti jane marre ne konsiderate keto faktore:

- Topografia e zones se kerkuar per shfrytezim dhe ne afersi te saj.
- Volumi i zbulimit qe do te kryhet, menyra e transportit dhe sheshet e depozitimit.
- Vlera mesatare e koeficientit te zbulimit.
- Volumi i pergjithshem i rezervave te nxjerrshme.
- Mundesite e lidhjes se objektit me rruge sa me te shkurtera me ato nacionale.
- Menyra e zgjedhur per rrezimin e mineralit Hekur-Nikel, ngarkimit dhe transportit te tij.
- Vetite fiziko-mekanike dhe gjeo-mekanike te formacioneve qe ndertojne objektin.
- Pervoja e akumuluar nga shoqerite e tjera qe zhvillojne aktivitetet te ngjashem ne afersi te ketij objekti.
- Investimet e kryera nga shoqeria per mjete ngarkimi dhe transporti

Marrja ne konsiderate e ketyre faktoreve dhe fakti qe shfrytezimi ne siperfaqe ne krahasim me shfrytezimin nentokesor ka prioritet mekanizimin e plote te proceseve kryesore te prodhimit, realizon siguri te larte ne pune, kushte te mira pune, efektivitet te larte dhe kosto te ulet.

Per kete fakt eshte zgjedhur shfrytezimi ne qiell te hapur (Karriere)

### **Punimet e zbulimit**

Ne fazen e pare do te pastrohet siperfaqja qe do te shfrytezohet nga trungjet dhe rrenjet e tyre. Ne siperfaqen qe do te kryhen punime zbulimi

Proceset kryesore ne kryerjen e punimeve te zbulimit jane: rrezimi, ngarkimi, transporti dhe stivimi i shkembinjve.

Tek rezervat gjeologjike sipas blloqeve dhame edhe koeficientin e zbulimit sipas pjeseve te vendburimit. Teknologjia e re e kohes lejon qe ky volum te llogaritet me nje sakesi me te madhe.

Per llogaritjen e volumit te zbulimit kemi perdorur llogaritjen e volumeve me metoden e prerjeve horizontale sipas izohipseve, ku siperfaqet jane matur me metoda kompiuterike duke perdorur formulat:

$$Vb = [(S1 + S2)/2] \times h \quad (1) \quad Vb = (S \times h)/3 \quad (2) \quad Vb = [(S1 + S2) + (S1 \times S2)^{1/2}] \times L/3 \quad (3)$$

## **Variantet e hapjes se minieres.**

### **1. Menyra e hapjes ne karriere**

Hapja e karrieres ne shfrytezimin siperfaqesor te mineralit Hekur-Nikel nga horizontet e punes ne karriere dhe transportin e tij do behet sipas shkalleve te karrieres, lidhja realizohet permes hapjes se transheve kapitale te cilat krijojne sistemin e rrugeve te transportit dhe sherbejne per pergatitjen e horizonteve te punes per shfrytezim.

### **2. Zgjedhja e menyres se hapjes se karrieres**

Faktoret ndikues ne zgjedhjen e menyres se hapjes:

- Kushtet gjeologjike dhe hidrogjeologjike te shtrirjes se vendburimit
- Topografia e zones qe do te shfrytezohet
- Pozicioni i vendosjes se trupit mineral dhe mundesia per depozitim e sterileve
- Tipi i zgjedhur per mjetin e ngarkimit dhe transportit
- Sistemi i zgjedhur per shfrytezim
- Prodhimtaria e minieres
- Shkalla e mekanizimit

### **Ne kushtet gjeologjike dhe hidrogjeologjike rol kryesor luajne :**

- Elementet e shtrirjes se vendburimit
- Kendi i renies se trupave
- Vetite fiziko mekanike te mineralit dhe shkembinjve ultrabazike.
- Ujembajtja e vendburimit

Ne kete projekt bazuar ne faktoret e mesiperme eshte zgjedhur hapja e vendburimit me transhe kapitale brenda zones se lejuar per shfrytezim qe lidh horizontin e fundit te shfrytezimit me horizontin e siperm te shfrytezimit.

### **Studimi dhe pershkrimi i varianteve te hapjes ne vartesi te punimeve te hapjes**

Ne zgjedhjen e menyres se hapjes se transhese jane marre ne konsiderate keta faktore:

- Vetite fiziko – mekanike te shkembinjve
- Vellimi i transhese
- Shpejtesia e kerkuar e avancimit
- Mjetet e ngarkimit dhe te transportit qe nevojiten per hapjen e saj

### **Menyra e hapjes se transheve**

Ne varesi nga detyra e transportit te mases se shkembinjve te shkrikeruar menyrat e hapjes klasifikohen:

- Me transport
- Pa transport
- Te kombinuar

### **3. Hapja e transheve me transport**

Menyra e hapjes se transheve me transport eshte me universale por me e kushtueshme

Hapja e transheve pa transport

Ne rastin e ketij projekti karriera shtrihet ne relief malor me shkembinj te qendrueshem, prandaj rekomandohet hapja e transheve pa transport pasi ka keto perparesi:

Siguron shpejtesi me te madhe ne hapjen e transheve ne saje te shfrytezimit racional te mjetit te ngarkimit i cili shkarkimin e materialit e ben direkt ne anen e poshtme te transhese.

Eshte menyre e thjeshte dhe ka siguri te larte ne pune.

Krijon mundesi per fillimin e transhese ne disa segmente njekoheisht.

#### **Percaktimi i kapacitetit prodhues**

Me afatin e ri qe ka ligji nn.10304 date 15.07.2010, jeta e minieres eshte 25 vite prodhimi. Nga ana tjeter kjo gje eshte kushtezuar edhe nga VKM nr.364 date 04.05.2011 “Per percaktimin e kriterëve te vleres minimale te siperfaqes se zones se lejuar minerare dhe te vleres minimale te investimit te prodhimit per nje leje minerare”, aneksi nr.2.

#### **3.4. Mbetjet e ngurta (Sterilet)**

Projekti ka parashikuar hapjen e nje sheshi per sterilet. Ne kete shesh do te vendosen sasi te shtreses se tokes, shkembinj, sipas rastit qe do te hasen dhe nuk do te jene me vlere per transport e perpunim. Per rehabilitimin e tyre, eshte hartuar nje raport rehabilitimi te demtimeve nga karriera.



## 4. VESHTRIM MBI MJEDISIN E RAJONIT TE IMPLEMENTIMIT TE PROJEKTIT

### 4.1. Te pergjithshme per Bashkin Has

#### Të dhëna të përgjithshme

##### Zona Gjeografike:

Hasi kufizohet në veri dhe perëndim me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Kukës dhe në lindje me Republikën e Kosovës. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Krumës, i cili u shpall qytet në vitin 1994.



*Harta e re territoriale e bashkisë Has*

#### Popullsia:

Sipas Censurit të vitit 2011, Hasi ka një popullsi prej 16,790 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, ka 21,247 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 399.62 km<sup>2</sup> me një densitet prej 53.16 banorë/km<sup>2</sup> sipas të dhënave të Regjistrimit Civil dhe 42.01 banorë/km<sup>2</sup> sipas Censurit 2011.

Kjo bashki përbëhet nga 4 njësi administrative, të cilat janë: Kruma, Fajza, **Gjinaj** dhe Golaj. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Hasit dhe të qarkut Kukës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 29 fshatra.

## **Profili i bashkisë**

Hasi është një zonë që mbijeton falë të ardhurave që vijnë nga emigrimi dhe bujqësia, megjithëse disponon burime të konsiderueshme minerare.

Pasuritë nëntokësore të këtij rajoni kanë nisur të shfrytëzohen në vitet '30 nga italianët. Deri në mesin e viteve '90 ka funksionuar miniera dhe fabrika e pasurimit të bakrit në Golaj, 6 kilometra larg qytetit të Krumës si dhe disa miniera më të vogla, ku ishin të punësuar mbi 3000 punëtorë. Jo vetëm banorët, por edhe specialistët thonë se nëntoka ende nuk është prekur. Për mineralin e bakrit dallohen zona Nikoliq Golaj, Krumë dhe Zahrisht në rrethin e Hasit.

Hasi është një zonë kufitare, ku një pjesë e banorëve kalojnë kufirin rregullisht për punësim apo për arsimim në zonën e Gjakovës në Kosovë, ku gjenden edhe lidhjet historike kulturore dhe ekonomike të krahinës. Relievi i zonës shtrihet nga rreth 300 metra mbi nivelin e detit deri në malet e larta të Gajrepit, Pashtrikut dhe Maja e Kunorës, të cilat gjenden në lartësitë 1400-1900 metra mbi nivelin e detit.

Hasi gjendet gjithashtu në shtegun turistik malor Theth-Valbonë-Kukës dhe turizmi rural apo malor mund të jetë një perspektivë e mirë ekonomike për këtë zonë.

Hasi njihet si krahinë etnografike me traditë të gjatë zejtare në produktet e leshit të punuara me shije si dhe për zanatçinj bukëpjekës.

Toka bujqësore e disponueshme për banorët e zonës u reduktua ndjeshëm pas ndërtimit të hidrocentralit të Fierzës, i cili përmbysi disa lugina dhe fshatra.

## **Sfidat me të cilat do të përballë pushteti vendor pas ndarjes së re**

Nisur nga fakti se ekonomia në rrethin e Hasit varet kryesisht nga burimet nëntokësore të Hekur-Nikelit, sfida kryesore mbetet koordinimi dhe bashkëpunimi mes institucioneve të Bashkisë dhe kompanive që punojnë në këtë sektor. Rigjallërimi i shfrytëzimit të minierave do të sillte rritjen e punësimit dhe mirëmenaxhimin e të ardhurave që merren nga kjo industri.

Kuadri ligjor ekzistues lejon transferimin e një pjese të taksave të industrisë minerare te njësitë e pushtetit vendor dhe burimet minerare aktualisht në shfrytëzim ose që mund të shfrytëzohen në të ardhmen mund të furnizojnë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të bashkisë së re.

Bashkia e re tashmë do të ketë nën juridiksionin e saj edhe fshatrat e tre komunave, ku një tjetër sfida që pret kryebashkiakun e Hasit ka të bëjë me riorganizimin dhe futjen në efikasitet të tokave bujqësore të rrethit të Hasit. Për shkak të fragmentarizimit të lartë dhe mungesës së organizimit, tokat e ndara me ligjin 7501 lihen aktualisht në një masë të madhe të papunuara. Ndërkohë, një pjesë e fermerëve kanë nisur t'i rikthehen pemëtarisë, si një mundësi ekonomike krahas blegtorisë, e cila siguron shumicën dërrmuese të të ardhurave. Për ta realizuar këtë, Bashkia duhet që të gjejë mënyrën dhe donatorët që të bëjë të mundur politikën stimuluese dhe subvencionuese.

Gjithashtu, bashkia e re e Hasit do të përballet dhe me një sërë nevojash për ndërhyrje në infrastrukturë, e cila raportohet si shumë e dëmtuar ose e munguar. Prioritet në këtë drejtim është asfaltimi i rrugëve lidhëse të fshatrave me qendrën e bashkisë, si dhe ngritja e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimeve.

### **Ekonomia**

Para vitit 1925, fshati Kukës banohej kryesisht nga banorë vendas, aktiviteti kryesor i të cilëve ishte bujqësia dhe blegtoria e cila zhvillohej në të dy anët e lumenjve Drin i Zi dhe Drin i Bardhë. Pas vitit 1925, Mbretëria Shqiptare i kushtoi një rëndësi të vecantë këtij fshati duke i dhënë statusin e një qyteti gjë që u bë shkak që ai të popullohet me banorë të ardhur nga Shkodra, Prizreni, Gjakova dhe Gora.

Ardhja e tyre shënon dhe futjen në jetën e këtij qyteti të aktiviteteve tregëtare dhe prodhuese. Janë këta banorë të rinj që i japin Kukësit një pamje të re përmes ndërtimit të shtëpive të reja dhe moderne dhe krijimit të një fryme të re qytetare përmes aktiviteteve sportive dhe kulturore. Falë tyre, Kukësi nis të bëhet i njohur si një nyje lidhëse dhe me rëndësi për të dy anët e kufirit.

Në ato vite nisën aktivitetin zeje të tilla si: kafet dhe restorantet, tregëtia me shumicë dhe pakicë, prodhimet e ëmbëlsirave, fotografia, mjetet moderne të transportit (biçikletat, veturat, kamionat dhe autobuzët) ngjyrosja dhe përpunimi i leshit, përpunimi i lëkurës dhe i mishit, prodhimi i rrobave dhe këpucëve, shërbimi postar dhe telegrafik, prodhimi i energjisë elektrike, përpunimi i metalit, prodhimet prej ari dhe argjendi, arkitekturë dhe plan urbanistik, një traditë e re gatimi dhe shërbimi, etj.

Kukësi para viteve 1990 ishte një qendër industriale në Shqipëri. Deri në vitet '90, Kukësi kishte një industri të nxjerrjes dhe shkrirjes së bakrit (teknologji sovjetike e viteve '60), nxjerrjes dhe koncentrimin të mineralit Hekur-Nikel, nxjerrjes së mineralit të kuarcit, prodhimin të materialeve të ndërtimit (materiale inerte, parafabrikate etj), përpunimit të lëndës drusore dhe prodhimin të mobiljeve, prodhimin të qilimave dhe sixhadeve, prodhimeve ushqimore (pije alkoolike, prodhime të qumështit, prodhime përpunuese të frutave dhe perimeve, prodhimin të bukës etj.), mbledhjes dhe përpunimit të bimëve mjekësore, prodhime të industrisë mekanike, shërbim hotelier përmes dy hoteleve turistike të cilat pritnin dhe përcillnin dhe disa qindra turistë të huaj, etj.

Kukësi ishte një vend i njohur dhe me traditë në rritjen dhe mbarështrimin e deleve. Cilësia e mishit dhe e leshit të deleve lumjane ishin të njohura në të gjithë Ballkanin.

Kukësi ishte gjithashtu një qendër e njohur e transportit. Krahas llojeve të tjera të transportit, aty ishte i zhvilluar dhe transporti ujor, përmes liqenit artificial të Fierzës, i cili bënte të mundur transportin e mallrave dhe të udhëtarëve.

Transformimet e domosdoshme ekonomike drejt tregut të lirë pas viteve '90 bënë që pjesa më e madhe e industrisë së lartpërmëndur të falimentojë tërësisht, sepse ajo industri ishte ngritur për të funksionuar në kushtet e një ekonomie të centralizuar dhe të planifikuar.

Mirëpo kjo shkaktoi shumë plage sociale, duke cuar në krijimin e një mase të madhe të papunësh.

Sot ekonomia e qytetit të Kukësit është e mbizotëruar nga biznesi individual apo ai familjar dhe kryesisht është e bazuar tek tregëtia e vogël. Degët zotëruese të ekonomisë ndër të tjera janë: transporti dhe shërbimet. Kukësi zotëron dhe një aeroport të përmasave ndërkombëtare (përfunduar së ndërtuari në fund të vitit 2004), mirëpo për dhënje me koncension të aeroportit "Nënë Tereza" të Rinasit, ai sot nuk funksionon. Kukësit i mungon infrastruktura moderne dhe vëcanërisht lidhjet me fshatrat dhe qytetet më të afërta si: Peshkopi, Shkodër, Krumë, Prizren etj. janë shumë të dobëta. Lidhjet telefonike ndonëse janë përmirësuar, ato janë ende në një gjëndje të mjeruar, për të mos folur për internetin, i cili ende nuk ka gjetur kushtet për t'u shtrirë nëpër familje.

Të gjithë këto faktorë, por dhe shumë faktore të tjerë e kanë detyruar qytetarin e Kukësit të braktisë vendin e të drejtohet për në Tiranë e zona të tjera apo edhe për të emigruar jashtë vendit. Ky proces ka shkaktuar dhe një largim në përmasa dramatike të njerëzve me arësim të lartë dhe me përvojë pune, duke shkaktuar kështu një boshllëk shumë të madh në administratën publike, në arësim dhe kulturë, shëndetësi etj.

### **Transporti**

Kukësi është një nyje ndërlidhëse natyrore e pjesëve të tjera të Shqipërisë me Kosovën e më tej. Largësia e Kukësit nga Tirana (kryeqyteti i Shqipërisë) është 210 km (kalimi nëpër Shpal), ndërsa largësia e kësaj rruge duke kaluar nëpër Pukë (rrugë që sugjerohet nga transporti ndërkombëtar) është 236 km.

Largësia e Kukësit nga Shkodra është 116 km. Largësia e Kukësit nga Peshkopia është 81 km. Largësia e Kukësit nga Bajram Curri është 87 km. Largësia e Kukësit nga Prishtina (kryeqyteti i Kosovës) është 122 km. Largësia e Kukësit nga Shkupi (kryeqyteti i Maqedonisë) është 155 km.

Lidhjet e qytetit me fshatrat rrëthuese dhe ato më të largëta janë në gjëndje jo te mire.

Të dhëna bazë

Banorë:	27000
Pozita gjeografike:	42.09°V, 20.43°L
Lartësia:	358 m m.n.d

### **4.2. Klima.**

Klima e rajonit është kontinentale me luhajtje të temperaturës nga -15 gradë në dimër dhe +34 gradë në verë me temperaturë mesatare vjetore +12-15 gradë celsius. Reshjet mesatare vjetore janë rreth 800 milimetra në vit. Muajt me më shumë reshje janë nëntori, dhjetori, janari dhe shkurti, muajt me më pak reshje janë korriku dhe gushti. Reshjet minimale vjetore janë 400mm ndërsa vlera maksimale ka arritur 1250mm në vit. Diellzimi mesatar vjetor është 53 kkal/cm<sup>2</sup>. Ndryshimi vjetor i diellit është 2480 ore. Lageshtia mesatare vjetore e ajrit është 68%. Drejtimi kryesor i erës është ai i erërave të veriut.

Presioni atmosferik sipas të dhënave shumë vjeçare lëviz nga 752-753 milimetra, (1002,6 – 1003,9m bar).

### 4.3. Ekosistemet, flora, fauna.

- Flora.

Qarku i Kukësit ben pjese ne brezin e shkurreve dhe drureve mesdhetare. Ne kete zone vazhdojne te mbijetojne ne pakice si: makiet, shibljacku, driza (paliurus spina-christi), cermedelli (cotunus coggygria), shqemia (rhus coriaria), murrizet, etj.

- Fauna.

Per zonen ne studim nuk dallohet per ndonje bote te pasur shtazore, ku karakteristika e zonave perreth dhe te qytetit jane zogjte shtegtar si dhe faunen e nje terreni te zakonshem te llojit are. Per zonen ne studim nuk zoterohet ndonje material i hollesishem. Zogjte qe karakterizojne zonen jane si: pellumbi (Streptopelia decaoto), trumcaku (Troglodytes), harabela (passer domesticus), kumriet, etj. Ndersa disa nga insektet qe ndodhen ne kete zone jane brumbuj, grereza, milingona, pilivesa, mushkonja, flutura etj. Ne perfundim mund te themi se zona eshte brenda konturit te nje zone qe ka qene toke are e pa shfrytezuar, e lene djerre, nje zone qe nuk dallohet per faune te pasur apo te mbrojtura nga legjislacioni ne fuqi dhe nuk eshte ndonje zone e frekuentuar nga shpende shtegetar pasi nuk eshte burim ushqimi per ta.

### 4.4. Kushtet klimatike

Rajoni i Kukësit dhe zona rreth objektit karakterizohet nga një klimë e nxehtë dhe e thatë gjatë verës dhe e ftohtë me lagështi në dimër . Temperaturat maksimale gjatë verës variojne 38<sup>0</sup> deri 40<sup>0</sup> temperatura mesatare mujore luhatet nga 20<sup>0</sup> deri në 25<sup>0</sup> C. Në peruidhën e dimrit temperaturat luhaten nga 10<sup>0</sup> deri në -20<sup>0</sup> C, temperatura mesatare e Janarit luhatet nga - 4 deri në + 2 °C . Gjatë dimrit bien dhe reshje bore , trashësia shkon deri në disa cm , ndërsa në veri në lartësitë mbi 1000 m reshjet e borës shkojnë nga 1 – 1.5 m . Reshjet e borës fillojnë në muajin Nëntor deri në muajin Prill .

Gjatë vitit në zonën tonë reshjet janë të shumta dhe sasia e tyre mesatare shkon nga 900 – 1300 mm dhe më shumë reshje bien në muajin Nëntor deri në muajin Maj.

Rajoni ku do të shfrytëzojmë është relativisht e zhveshur nga bimësia , megjithatë ajo pjesë që ndodhet përfaqësohet nga shkurre , shkoza , shqop dhe frashër në zonat e ulta dhe nga pisha , bredh , dushk dhe ah në zonat e larta , ku ato nuk përfaqësojnë pyje të mëdhenj, por grumbullime me pak drure të veçuar të këtyre llojeve . Pjesa e ulët e zonës është e pa populluar dhe ka kryesisht tokë te punueshme pak në të cilën kultivohen drurë frutorë si mollë , dardha , kumbulla etj.gjithashtu dhe bimët e drithërat e bazës ushqimore te gjësë së gjalle që mban ky komunitet.

### 4.5. Sizmiciteti ne rajon

Bazuar në materialet e publikuara nga Instituti Sizmologjik i Akademisë Shqiptare të Shkencave, luhatjet sizmike të supozuara do të kenë një madhësi 6.8-6.9(VII) gradë sipas shkallës MSK-64 ose MM të Modifikuar të Merkalis.

Mjedisi i ndërlikuar strukturor i Shqipërisë i përket Rajonit të Mesdheut qendror. Ku pllakat kontinentale të Afrikës dhe të Evropës përplasen duke krijuar disa breza aktivë sizmikë. Në veçanti, Shqipëria ndodhet në vendtakimin midis mikroplakës së Adriatikut dhe pllakës Euroaziatike dhe karakterizohet nga një veprimtari e fortë e mikro-tërmetejeve

dhe nga tërmete të madhësive të vogla dhe të mesme dhe vetëm rrallë nga tërmete të forta.

#### 4.6. Cilësia e ajrit

##### Cilësia e ajrit-

Shkarkimet e gazeve acide në atmosferë kanë një ndikim negativ mbi ekosistemet e ujërave të ëmbla, të cilat janë të ndjeshme ndaj aciditetit si edhe ndaj cilësisë dhe përbërjes kimike të tokës. Gjithashtu, kjo dukuri shkakton dëmtime në trashëgiminë kulturore sepse pakëson gradualisht cilësinë dhe fortësinë e monumenteve kulturore, ndërtesave prej mermeri etj. Për më tepër, çlirimi i përbërësve të azotit në atmosferë, shkakton atrofizimin në ekosistemet tokësore dhe detare.

Burimi kryesor i çlirimeve të substancave acide në mjedis janë emetimet e gazta, që përmbajnë dyoksid sulfuri  $SO_2$ , okside të azotit  $NO_x$  dhe amoniak  $NH_3$ . Këto gaze krijohen gjatë djegies së substancave organike të djegshme në sektorët e shërbimeve, transportit, prodhimit të energjisë, industrisë kimike dhe metalurgjike etj. Pas çlirimit në atmosferë, këto gaze shpërndahen në hapësirë dhe mund të qëndrojnë për disa kohë në gjendje të shpërhapur.

Gazet  $SO_2$ ,  $NO_x$ , dhe  $NH_3$  bien direkt në sipërfaqen e tokës dhe vendosen në bimësi dhe elementë të tjerë mjedisorë ose bien në gjendje të lagësht së bashku me borën, shiun, mjegullën etj. Këto gaze (si rezultat i zhvillimit të disa reaksioneve kimike) shndërrohen në acide squfuri dhe azoti kur ato qëndrojnë në atmosferë, si edhe kur bien në tokë. Ligji Nr. 8934, i datës 5 Shtator 2002 mbi Mbrojtjen e Mjedisit siguron për adoptimin e programeve të kontrollit të ndotjes në Shqipëri, megjithatë për zonën në vleresim nuk ka të dhëna të publikuara mbi cilësinë ekzistuese të ajrit të lidhura me çlirimin e  $SO_2$  ose  $NH_3$ . Te dhëna të monitorimit për zonën e zbatimit të projektit nuk disponohen pasi konsiderohet si një zonë pa aktivitete ndotëse. Cilësia e ajrit në zonat malore të vendit të cilat ndodhen larg zonave urbane dhe industrise se rende, është brenda normave të cilësise se një ajri të pastër.

##### Zhurmat

Lidhur me zhurmat, në zonën e studimit nuk ka ndonjë informacion në lidhje me nivelet e ndotjes së ambientit. Zhurma nuk është shqetësimi kryesor në zonën që rrethon këto zone rurale drejtpërdrejt. Aty nuk ka burime emetimi të ndjeshëm zhurmash. Nivelet e zhurmës brenda fshatrave janë tipike për çdo zonë rurale të nivelit të fshatrave dhe janë të lidhura kryesisht me trafikun e automjeteve që është në nivel minimal por infrastruktura e dobët ndikon në rritjen e këtij niveli. Megjithatë rekomandohet që nivelet e zhurmës duhet të monitorohen gjatë ndertimit por edhe gjatë operimit.

#### 4.7. Mjedisi biologjik i rajonit

##### Zonat e Mbrojtura

“Zona të mbrojtura” shpallen territore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, bashkëshoqëruese, të cilat menaxhohen me rrugë ligjore dhe me metoda shkencore bashkëkohore. Në Shqipëri, Zonat e Mbrojtura janë të konsideruara si pjesë/sipërfaqe e tokës dhe/ose ujit, detare/bregdetare, të destinuara kryesisht për konservimin e biodiversitetit, burimet natyrore dhe kulturore që shoqërojnë atë/ato dhe që janë të menaxhuara në mënyrë të ligjshme dhe/ose në mënyra të tjera efektive. Rrjeti i zonave të mbrojtura është bazuar në kategoritë e menaxhimit të IUCN dhe sistemi i ndërtuar për këtë qëllim është në përputhje me sistemin ndërkombëtar IUCN. Të gjashtë kategoritë e sistemit janë ekuivalente, të barabarta dhe të rëndësishme dhe ato përfshijnë të gjitha nivelet e ndërhyrjes njerëzore, të pranueshme për kategorinë respektive. Krijimi i Zonave të Mbrojtura ka filluar që në vitin 1940. Në 1981, për herë të parë, asete të rralla natyrore u vendosën në mbrojtjen shtetërore duke shpallur si Monumente të Natyrës pyjet me vlerë shkencore, biologjike, historike dhe didaktike. **Zona ne vlerësim nuk vlerësohet si zone me status te veçante nga MM.** Sic shihet edhe ne hartën e meposhteme, zona ne vlerësim nuk përmban sipërfaqe të mbrojtura.

Përveç zonave të mbrojtura sipas hartës së mesipërme të cilat mund të jenë të llojit:

- a) Rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor/ (Kategoria I);
- b) Park kombëtar (Kategoria II);
- c) Monument natyror (Kategoria III);
- ç) Rezervat natyror i menaxhuar/zonë e menaxhimit të habitateve dhe llojeve (Kategoria IV)
- d) Peizazh i mbrojtur (Kategoria V);
- dh) Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara/zonë e mbrojtur me përdorim të shumëfishtë (Kategoria VI).

Rreth një zone të mbrojtur mund të shpallet një zonë buferike.

Përveç statusit të mesipërme të zonave të mbrojtura të cilat paraqiten në lartë , pranë kësaj zone ndodhet Monumenti i Natyrës “Pisha e Gjegjanit”, e cila ndodhet afër fshatit Gjegjan 700 m mbi nivelin e detit, me lartësi 20 m, diametër të trungut 1 m, perimetër të kurores 27-29 m dhe moshe mbi 300-vjeçare. Ka vlera shkencore, biologjike, ekologjike, turistike. Vizitohet sipas rrugës Kukës-Gjegjan. Por ky monument nuk preket nga zhvillimi i projektit në vlerësim.

## **5. VLERESIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS DHE MASAT PARANDALUESE GJATE SHFRYTEZIMIT TE OBJEKTIT MINERAR DHE PAS MBYLLJES SE AKTIVITETIT.**

### **5.1. Te pergjithshme**

Veprimtaria që propozohet të kryhet ka përmasa relativisht të mëdha qoftë të karakterit të investimeve ashtu edhe të outputeve që do të japë gjatë shfrytëzimit të saj. Kjo është arsyeja që mbetet e një rëndësie të veçantë të analizohen ndikimet që do të ketë ajo që nga çasti i nisjes së hartimit të projektit, shqyrtimi dhe miratimi i koncesionit, para fillimit të punimeve të germimit dhe më tej gjatë shfrytëzimit të saj deri në mbylljen e këtij aktiviteti. Ky kapitull i vleresimit të ndikimeve në mjedis do të paraqesë një analizë të hollësishme të ndikimeve të mundshme negative dhe pozitive duke specifikuar edhe masat zbutëse që duhet të aplikohen për të eliminuar apo për të minimizuar sado pak ndikimet negative në mjedis.

Kjo analizë kryhet duke u bazuar në projektin e konceptuar të diskutuar si më lart në këtë raport, konsultimit me publikun, identifikimi i pasurisë natyrore të rajonit dhe përmasave të projektit. Ndikimet në mjedis të kësaj raporti të përmbledhur vlerësohen për fazën paraprake të konsultimit me publikun dhe më pas plotësohen me informacione dhe problematika të hasura gjatë rrugës për hartimin e raportit të thelluar të Vleresimit të Ndikimit në Mjedis.

Ndikimet në mjedis mund të grupohen si më poshtë:

- Kimike-Fizike të cilat lidhen me ndikimet mbi burimet natyrore si edhe proceset e degradimit fizik të mjedisit vetë.
- Biologjike-Ekologjike përfshirë burimet natyrore, ruajtjen e biodiversitetit, ndikimin mbi jetën e gjallë të ndotjes së biosferës
- Sociologjike të lidhura me komunitetin apo edhe individët e veçante, ndikimin mbi trashëgiminë kulturore dhe progresin e supozuar.
- Ekonomike-Makroekonomike të cilat marrin parasysh ndikimet e përkohshme apo të përhershme shkaktuar për shkak të realizimit të projektit.

### **5.2. Vleresim i impakteve kryesore në mjedis**

Vleresimi i ndikimeve në mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi “Ndotësi paguan”



Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut  
Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” dhe VKM Nr. 13, date 04.01.2013 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis” dhe ka si synim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- e) Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- f) Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
- g) Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.:

Sa me siper vleresimi i ndikimeve ne mjedis do te vleresoje:

- Ndikimet ne ajer
- Ndikimet ne ujera
- Ndikimet ne toke
- Ndikimet ne biodiversitet (mjedisi biologjik)
- Ndikimet ne mjedisin social-ekonomik
- Ndikimet qe shkaktojne ndryshimet klimatike

### **5.2.1. Ndikimet ne ajer**

**(Cilesia e ajrit, zhurmat, vibrimet, peizazhi.)**

#### ***Impakti:***

Hapja dhe perdorimi i rrugeve do te shkaktoje ndikim ne cilesine e ajrit, do te ngrihen pluhura pergjate trasese se rruges dhe ne sheshin e punimeve ne rast se nuk aplikohet lagia me uje gjate sezonit me thatesire. Shkarkimet e gazeve te mjeteve motorike do te jene burime te shkarkimeve te gazeve te demshme per ajrin. Perdorimi i lendeve plasese do te jete nje burim tjetër i pluhurit dhe lendeve te tjera te ngurta ne ajer. Zhurmat jane normale per nje aktivitet te tille, por qe nuk do te jene shqetesuese per zonat e banuara. Kryesisht zhurmat shkaktohen nga shperthimet e masivit te shkembit, nga transporti, germimet e tokes shkembore, etj. Vibrimet do te jene prezente vetem gjate procesit te perdorimit te lendeve plasese per shkeputjen e masivit. Ndikimi i tyre varet edhe nga drejtuesi teknik i cili duhet te ruaj nivelin e perdorimit te lendeve plasese.

Gjate punimeve do të ketë demtim të rëndësishëm të peizazhit të zonës, nga germimet dhe humbja e bimesise, ndryshimi i relievit, heqja e shtresës humusit, depozitimi i sterileve, hapja e rrugëve të reja, ndërtim i perkohshëm i objekteve dhe magazinim të materialeve ndërtimore. Sheshi i parkimit dhe makinerite gjithashtu do të kenë efekt në peizazhin e zonës.

***Masa parandaluese:***

Aplikimi i lagës së trasës dhe kantierit me ujë gjatë sezonit me thatësire për të reduktuar pluhurat. Kufizimi i orarit të punës vetëm gjatë ditës për të reduktuar zhurmat. Përdorimi i mjeteve bashkëkohore dhe me kriter të brenda kushteve teknike. Përdorimi i mjeteve dhe materialeve cilësore e eficientë. Monitorim i cilësive së ajrit gjatë fazës së punimeve. Menaxhim i sterileve të depozituara dhe të sheshit të grumbullimit të shtresës së humusit.

Ky projekt ndikon në permassa të konsiderueshme në mjedisin biologjik të zonës. Këtë efekt mund ta reduktojë vetëm zbatimi i një projekti rehabilitimi të detajuar të sipërfaqes së shfrytëzuar të karrerës.

**5.2.2. Ndikimet në ujëra**

**(Ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore.)**

***Impakti:***

Nga zbatimi i këtij projekti ndikimet në ujëra do të jenë prezente. Ndikimi në ujërat sipërfaqësore e nëntokësore do të vijë si rrjedhojë e punimeve në sipërfaqe. Hasja e burimeve ujore gjatë germimeve do të shkaktojë daljen në sipërfaqe të ujërave nëntokësore, fenomen i cili mund të shoqërohet edhe me erozion dhe shpëlarje të tokës, varferim të ujërave nëntokësore dhe ndotjen e ujërave sipërfaqësore të burimeve të zonës.

***Masa parandaluese:***

Të orientohen ujërat e shiut, duke mos krijuar erozion dhe të mos krijohen pellgje uji në mjedisin e karrerës. Të orientohen ujërat nëntokësore që mund të dalin në sipërfaqe gjatë germimeve, duke mos lejuar rrjedhjen e tyre në mënyrë të pakontrolluar në mjedisin e zonës. Nëse do të shihet e nevojshme, të ndërtohet edhe një vaske dekantimi e filtrimi të ujit të kantierit. Makinerite të mos shkarkojnë substanca të dëmshme në mjedisin ujor të zonës.

**5.2.3. Ndikimet në tokë**

**(Relievi, sipërfaqja, përberja e strukturës së tokës, nëntoka.)**

***Impakti:***

Nga zbatimi i këtij projekti ndikimet mbi tokë do të jenë jo të vogla, zhvillimi i këtij aktiviteti kërkon një hapësirë relativisht të madhe në tokë pasi kërkon një shtrirje në

siperfaqe, ne total prej 0.647 Km<sup>2</sup>, por kuptohet qe nuk do te shfrytezohet e gjitha, sipas deklarimit te investitorit. Kjo siperfaqe e cila eshte pyjore, do te merret ne perdorim nga subjekti qe ka fituar tenderin e shfrytezimit te ketij objekti dhe duhet te rehabilitohet ne perfundim te shfrytezimit. Per te kryer nje rehabilitim te plote dhe afatgjate, duhet qe shfrytezimi te jete me shkalle te rregullta dhe te jete ruajtur shtresa e dheut ne siperfaqen e germuar.

Perdorimi i tokes konsiston ne shfrytezimin afatgjate te saj si shesh i punimeve te minieres, por edhe ne zenien e saje ndonese ne siperfaqe te vogla per depozitimin e perkohshem te shtreses se humusit dhe depozitimin e sterileve.

Ne lidhje me efektin e erozionit per skarpatat e trasese se rruges veme ne dukje se projekti do te ndikojte ndjeshem pasi eshte terren i pjerrret.

Gjithashtu duhen kryer edhe punime mbrojtese per sheshet e depozitimit te inerteve, si dhe depozitimit e ruajtjes se mineralit.

Pritet nje ndryshim i struktures dhe perberjes se siperfaqes se tokes gjate shfrytezimit dhe pas punimeve te rehabilitimit te siperfaqeve te demtuara. Si rrjedhoje e punimeve te shfrytezimit, do te kemi edhe ndryshim te relievit.

#### ***Masa parandaluese:***

Masat parandaluese do te ishin te nevojshme per reduktimin e impaktit mbi toke te ketij projekti. Rekomandojme ndertimin e pritave me mure guri, ose gjerdhe prej druri, ose me rrjete teli e bimesi autoktone. Rehabilitimi i siperfaqeve sa me shpejt te jete e mundur per te mos humbur siperfaqe toke. Ruajtja e humusit per te rehabilituar siperfaqet e demtuara, si te skarpaceve te rruges dhe te shkalleve te shfrytezimit. Sistemimi dhe rehabilitimi nepermjet perdorimit te sterileve per mbushjen e shkalleve dhe shesheve pas perfundimit te shfrytezimit te karrieres. Mbjellje e bimesise autoktone per te ruajtur strukturen dhe perberjen natyrale te tokes.

#### **5.2.4. Ndikimet ne biodiversitet (Flora dhe fauna )**

##### ***Impakti:***

Ndikimi kryesor dhe me i rendesishem ne mjedisin biologjik eshte gjate fazes se punimeve per hapjen dhe shfrytezimin e minieres dhe te aksesit rrugor. Realisht pritet nje efekt domethenes ne demtimin e bimesise se zones, pasi prane kesaj zone ndodhet monumenti i natyres “Pisha e Gjegjanit”, monument i cili nuk preket nga zhvillimi i aktiviteti “Shfrytezim i mineralit Hekur-Nikel”. Demtimi i siperfaqes se tokes dhe i shtreses bimore te cilat sherbejne si habitat per nje sere gjallesash do te ndikonte edhe ne largimin e faunes se zones. Kryesisht kafshet e egra, zogjte dhe insektet e zvarraniket.

Ndikimi i zhurmave do të ndikojë edhe në largimin e faunes në një rreze disa qindra metra ose edhe në km, kjo kryesisht nga aktiviteti i përdorimit të lendeve plasese për përdorim civil, që shërbejnë për shkeputjen e masivit shkëmbor.

***Masa parandaluese:***

Rehabilitimi sa më parë i skarpave dhe sipërfaqeve pyjore të demtuara dhe investimi në ndërtimin e pritave për reduktimin e erozionit. Zbatimi i projektit të rehabilitimit sipas preventivit të detajuar të punimeve rehabilituese dhe monitorimi i ecurisë së këtij procesi në vazhdimësi. Mirembajtje dhe monitorim të vazhdueshëm të terrenit problematik edhe nga erozioni natyror në segmente të caktuara. Mbjellja e bimesave autoktone dhe sipas skemës së projektuar për të ndikuar ndjeshëm në uljen e erozionit dhe në ruajtjen e identitetit të bimesave të zonës. Si rrjedhojë edhe rikthimin e faunes autoktone të larguar përkohej.

**5.2.5. Ndikimet në mjedisin social-ekonomik**

**(Mjedis social-kulturor dhe ekonomik, përdorimit të tokës, përdorimi i burimeve ujore.)**

***Impakti:***

Ndikimi në mjedisin social-kulturor dhe ekonomik nga faza e zbatimit të punimeve të shfrytëzimit të mineraleve, vlerësohet të jetë pozitive. Kjo për shkak të nivelit të ulët ekonomik të zonës dhe rritjes së punësimit nga projekti shfrytëzimit, por edhe të traditës së zonës, banorët e të cilëve kanë punuar prej vitesh në miniera. Investitori do të kryejë edhe disa punime të tjera si hapje rrugë dhe mirembajtje të rrugës ekzistuese. Gjetja e objekteve arkeologjike gjatë punimeve do të ndryshonte rrjedhën e punimeve, megjithatë nga instituti përkatës nuk identifikohen të tilla. Investimi i tillë, ndikon në zhvillimin ekonomik dhe social-kulturor të zonës.

Përdorimi i tokës aktualisht është për blejëtori, nuk përfshihen tokat bujqësore. Përsa i përket burimeve ujore, nuk përdoren për këto veprimtari. Nga burimet e zonës, do të krijohet mundësia e furnizimit me ujë për plotesimin e nevojave të punëtorëve dhe të ambientëve të punës.

***Masa parandaluese:***

Plotesimi i kërkesave të komunitetit, ruajtja dhe mirembajtja e infrastrukurës rrugore të zonës, punësimi i komunitetit të zonës, rritja e investimeve në sektorë të ndryshëm dhe kontributi në taksat vendore. Krijimi i kushteve të mira të punës, siguri në punë dhe zbatimi i kushteve teknike duke investuar në hapjen dhe mirembajtjen e minierës.

### **5.2.6. Ndikimet qe shkaktojne ndryshimet klimatike**

**(Ndryshimi i klimes, emetimi i substancave ozon-holluese.)**

***Impakti:***

Projekti ne vleresim nuk do te perfshije substanca te tilla qe mund te ndikojne ne rritjen e perqendrimit te lendeve ozon-holluese ne atmosfere. Vleresohet vetem lenda djegese e mjeteve te renda te punimeve te germimit, megjithese ne nivele te uleta. Faktor tjetër negativ mund te vleresohet reduktimi i bimesise se zones dhe pakesimi i filtrimit te ujit te rreshjeve.

***Masa parandaluese:***

Rekomandojme rehabilitimin e mjedisit te demtuar dhe mbjelljen e pemeve ne raport 1 me 3.

### **5.3. Ndikimet nderkufitare**

Projekti ne vleresim nuk prek mjedisin kufitar. “nuk ben pjese ne projektet me ndikim nderkufitar, shfrytezim te ujrave ndërkombëtare” dhe projekte te “Sigurisë së Digave” pasi ky projekt do te jete ne brendesi te territorit te vendit dhe nuk perdor burime ujore. Siperfaqja e demtuar nga zbatimi i ketij projekti, mund te rehabilitohet dhe te ripyllezohet ne pjesen me te madhe te saj, pothuajse ne masen 100% te siperfaqes.

### **5.4. Menaxhimi i mbetjeve te ngurta**

Projekti ka parashikuar hapjen e nje sheshi per sterilet. Ne kete shesh do te vendosen sasi te shtreses se tokes, shkembinj, sipas rastit qe do te hasen dhe nuk do te jene me vlere per transport e perpunim. Per rehabilitimin e tyre, eshte hartuar nje raport rehabilitimi te demtimeve nga kariera.